



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:117665

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05669616

C.nr.278/15

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen juridike të paditëses R.L. ,nga Ferizaji rr'....'',nr.60,të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson avokati Avni Ibrahimimi ,nga Ferizaji ,kundër të paditurve Sh.R. ,nga Fshati T.J. Komuna e Ferizajit, tani me adresë të panjohur të vendbanimit ,B.J., B.J., L.J. nga Ferizaji Rr''....,tani me adresë të panjohur të vendbanimit ,baza juridike vërtetimi i pronësisë,me datë 10.05.2024 merrë këtë:

A K T V E N D I M

I.Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paditëses R.L. për ndërprerjen e procedurës

II.Hedhet Poshtë si e palejueshme në tërësi padia e paditëses R.L. ,e parashtruar kundër të paditurve Sh.R.,nga Fshati T.J. Komuna e Ferizajit, tani me adresë të panjohur të vendbanimit ,B.J., B.J., L.J. nga Ferizaji Rr''....me bazë juridike vërtetimi i pronësisë,për pjesën e parcelës kadastrale kadastrale me sipërfaqe prej 389 m2 ,Zona N.

A r s y e t i m

Paditësja R.L. ka parashtruar padi kundër te paditurve Sh.R. ,nga Fshati T.J. Komuna e Ferizajit, tani me adresë të panjohur të vendbanimit ,B.J., B.J., L.J., Ferizaji Rr''....,tani me adresë të panjohur të vendbanimit ,baza juridike vërtetimi i pronësisë.

Nga certifikata e pronës e datës 29.01.2018 rezulton se parcela kadastrale me sipërfaqe prej 8177 m2 ,Zona Kadastrale N....evidentohet në emër të të paditurve B.J., B.J dhe L.J.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata ka konstatuar se të paditurit e kanë adresën të panjohur të vendbanimit, prandaj në pamundësi që të ftohet për shqyrtim gjyqësor, të njëjtve parashihej tu caktohet përfaqësuesi i përkohshëm ,me qëllim që i njëjti ti përfaqësoj të paditurit gjersa të ekzistojnë shkaqet që kanë shërbyer si bazë për caktimin e të njëjtit si përfaqësues i përkohshëm në bazë të nenit 79 par.3 pika a e LPK-së.

Kurse në bazë të nenit 81 paragrafi 2 i LPK-së paditësja ka për detyrë të deponoj shumën e nevojshme për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm.

Gjykata me qëllim të eliminimit të pengesës procedurale që ka të bëj me përfaqësimin ligjorë të të paditurve, ka nejturr aktvendimin e datës 16.09.2022 ,me të cilin e ka detyruar paditësen që në emër të përfaqësimit të përkohshëm ,të deponoj në Gjykatën Themelore në Ferizaj,përmes arkatarit të kësaj gjykate shumë e të hollave prej 1534 euro ,në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit .

Nga fletëdërgesa për dorëzim personal e cila gjindet në shkresat e lëndës vërtetohet se përfaqësuesi i paditëses aktvendimin që ka të bëj me deponimin e shpenzimeve për përfaqësues të përkohshëm e ka pranuar me datë 20.09.2022 mirëpo pala paditëse nuk e ka bërë deponimin në afatin e paraparë me aktvendim es as pas atij afati të paraparë me aktvendim fakt ky që konstatohet nga shikimi në sistemin smil dhe në shkresat e lëndës.

Kurse veprimi gjykatës për të eliminuar mungesat gjegjësishtë pengesat që kanë të bëjnë me përfaqësimin ligjor të të paditurve bazohet edhe në nenin 390 të LPK-së,në pjesën ku flitet për përfaqësimin ligjorë.

Duke marrur parasysh faktin se për shkak të mos deponimit të shpenzimeve për përfaqësues të përkohshëm nuk mund të zhvillohet procedurë kontestimore në këtë rast konkret sepse nuk mundësohet përfaqësimi ligjor i të paditurve ,kurse gjykata nuk ka autorizimin ligjore në këtë rast që gjykimin ta zhvilloj pa pranin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurve ,gjykata e ka Hedhur Poshtë si të palejueshme padin e paditëses të parashtruar kundër të paditurve,me aplikimin edhe të nenit 391 paragrafi 1 pika g të LPK-së.

Përveq kësaj padia e paditëses është e palejuar edhe nga fakti sepse e njejta edhe përkundër udhëzimit nga gjykata që ta përfshij si palë S.L. –fëmijë i të ndjerit K.L.një veprim të till nuk e ka bërë deri tani,kurse qdo herë kur kërkohet vërtimi i pronësisë për një pasuri për të cilën pretendohet se e ka blerë personi vdekur cilësinë për të qenë palë e kanë gjithë trashëgimtarët e të njejtë.

Kërkesa për ndërprerjen e procedurës është refuzuar nga gjykata ,sepse nuk është paraparë mundësia me ligj që në rast kur nuk dihet adresa e të paditurit të ndërprehet procedura.

GJYKATA THEMEORE NË FERIZAJ

Gjyqtari
Burim Emërllahu

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi, nëpërmes të kësaj gjykate.